

## ZGJEDHJET VENDORE 2023

# INTEGRITETI DHE ROLI I BURIMEVE SHETËRORE

---

Janar – Maj 2023

DRAFT PËRMBLEDHËS

*Raporti i plotë do të jetë publik së shpejti në faqen zyrtare të ISP [www.isp.com.al](http://www.isp.com.al)*

*Projekti “Monitorimi i përdorimit të burimeve shtetërore në fushatën për zgjedhjet vendore 2023” realizohet nga Instituti i Studimeve Politike me mbështetjen e fondacionit Konrad Adenauer (KAS).  
Pikëpamjet e shprehura në raport janë përqiejësi e ISP-së.*

Institucioni i zgjedhjeve pluraliste dhe konkurruese ka histori të brishtë në Shqipëri, rruga për të pasur standarde të plota të zgjedhjeve të lira, të ndershme dhe të barabarta është ende e gjatë. Prej vitit 1991 Shqipëria zhvillon zgjedhjet parlamentare konkurruese dhe prej vitit 1992 zhvillohen zgjedhje vendore konkurruese. Procesi i fundit zgjedhor (2019) përbën një përjashtim në natyrën konkurruese të zgjedhjeve, për shkak të bojkotimit të partive kryesore opozitare dhe procesit formal që e shoqëroi atë. Zgjedhjet e vitit 2021 ishin një test politik për aftësinë e Shqipërisë për të reflektuar nga gabimet e të kaluarës, zgjedhjet vendore të vitit 2023 ishin test për të dëshmuar se Shqipëria, tashmë në bisedime për anëtarësim në BE ka maturinë dhe kapacitetet për të jetësuar standarde shumë më të larta zgjedhore, sesa praktikatat eksperimentale dhe problematike të tranzicionit.

Zgjedhjet janë mekanizmi i vetëm i shprehjes dhe ushtrimit të sovranitetit qytetar në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose përmes përfaqësuesve dhe parimi i parë në Kushtetutën e RSH, sipas të cilit, “qeverisja bazohet në një sistem zgjedhjesh të lira, të barabarta, të përgjithshme e periodike”<sup>1</sup>. Në konceptin e demokracisë funksionale, zgjedhjet janë parakusht për qeverisjen demokratike, pasi nëpërmjet tyre qytetarët e një vendi zgjedhin lirisht dhe bazuar në ligj personat që mund të qeverisin në mënyrë legjitime në emër dhe në interes të tyre. Mbajtja e zgjedhjeve demokratike të cilat marrin parasysh të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe që janë të bazuara në sundimin e ligjit, në fund të fundit kontribuon në krijimin e procedurave dhe institucioneve që formojnë qeverisjen e mirë<sup>2</sup>.

Pjesë thelbësore e vlerësimit të standardeve të zgjedhjeve është edhe treguesi i rolit të shtetit në fushatë, roli i burimeve shtetërore dhe publike, roli i institucioneve ekzekutive qendrore dhe vendore, roli i administratës civile dhe enteve publike. Sipas praktikave ndërkombëtare, pyetja themelore mbetet nëse autoritetet ekzekutive veprojnë “*në mënyrë të paanshme, të kufizuar, profesionale dhe të përshtatshme gjatë fushatës*”<sup>3</sup>. Partitë dhe kandidatët kanë nevojë për burime njerëzore, materiale dhe financiare, akses sa më të madh në publik, lehtësim në aktivitetet partiake, mbështetje dhe informacion. Ato kanë nevojë që këto burime t’i sigurojnë në masë më të madhe sesa pala tjetër rivale, në mënyrë që të dominojnë fushatën. Në një konkurrencë të tillë është e kuptueshme se pala që është në pushtet dhe që administron më shumë burime njerëzore, struktura, burime buxhetore, akses në informacion, etj, është edhe më e privilegjuar sesa palët e tjera. Në një demokraci solide midis tyre nuk ka diferenca të theksuara dhe qenia në pushtet nuk passjell privilegje

---

<sup>1</sup> Kushtetuta e RSH (1998), neni 1. *Shqipëria është Republikë parlamentare. Republika e Shqipërisë është shtet unitar dhe i pandashëm. Qeverisja bazohet në një sistem zgjedhjesh të lira, të barabarta, të përgjithshme e periodike. Sovraniteti në Republikën e Shqipërisë i përket popullit. Populli e ushtron sovranitetin nëpërmjet përfaqësuesve të tij ose drejtpërsëdrejti.*

<sup>2</sup> Këshilli i Evropës. *Botim mbi zgjedhjet*, 2016, f.9. <https://rm.coe.int/16806fb934>

<sup>3</sup> *Po aty*, f. 117.

të dukshme elektorale, por në një demokraci të brishtë apo model hibrid, ku konkurrenca midis palëve politike është vetëm disa mijëra vota, përdorimi i burimeve shtetërore mund të passjell impakt elektoral dhe ndikim në rezultatin e votimit.

***Një sërë pyetjesh të rëndësishme marrin vlerë lidhur me burimet shtetërore në fushata elektorale:***

*A mbulohet keqpërdorimi i burimeve shtetërore (ambienteve shtetërore/lokaleve, infrastrukturës, mjeteve dhe punonjësve) për fushatat zgjedhore? Nëse po, një sjellje e tillë a është qartë dhe mjaftueshëm e kufizuar ose e ndaluar me ligj? A përdoren burimet e shtetit për të detyruar ose për të ndikuar mbi një ose më shumë subjekte garuese politike? Çfarë lloje burimesh administrative përdoren? Burimet shtetërore e publike në fushata mund të jenë institucionale (zyra, staf, pajisje, automjete, etj.), buxhetore (përdorimi i drejtpërdrejtë i buxheteve publike), ose të lidhura me median (përdorimi i organizatave shtetërore/të medias publike). A përdoren ambientet, infrastruktura apo automjetet e institucioneve publike për qëllime të fushatës zgjedhore të partive politike ose kandidatëve të veçantë në mënyra të ndaluara ose të parashikuara nga dispozitat ligjore për rolin shtetëror? A marrin pjesë punonjës të administratës publike në aktivitete të fushatës gjatë orarit të punës? Nëse janë keqpërdorur burimet administrative, cili është përfitimi financiar i vlerësuar i këtyre burimeve për partitë ose kandidatët?*

*Në rastin shqiptar, pyetja e përhershme është, - sa përputhet dhe mbivendosen agjenda ekzekutive dhe normale e funksionimit të institucioneve me agjendën elektorale? Cila merr prioritet para dhe gjatë fushatës elektorale? Sa të pavarura dhe me integritet janë institucionet dhe sa vetë partitë zotërojnë kulturën demokratike të ndarjes së burimeve shtetërore nga aktivitetet politike elektorale? Gjithashtu, merr vlerë të veçantë edhe roli i institucioneve të garancisë, nëse KQZ duhet të jetë “polici” zgjedhor apo përgjegjës për një kuadër rregullator monitorimi e vlerësimi? Nëse politika penale ndaj shkeljeve që bëjnë partitë dhe kandidatët është proporcionale apo disproporcionale me shkeljet ligjore të të njëjtës masë, por pa lidhje me zgjedhjet që bëjnë qytetarët?*

Bazuar në këto vlerësime dhe rëndësinë e integritetit të zgjedhjeve vendore 2023, **Instituti i Studimeve Politike (ISP) me mbështetjen e fondacionit “Konrad Adenauer” realizoi projektin “Për monitorimin e përdorimit të burimeve shtetërore në fushatën për zgjedhjet vendore 2023: rasti i bashkive Tiranë, Durrës, Elbasan, Fier dhe Korçë”**. Prej disa vitesh Instituti i Studimeve Politike (ISP) harton raporte periodike jopublike lidhur me progresin e shënuar nga Shqipëria në lidhje me kushtet e përcaktuara nga Bundestag-u gjerman, midis të cilave bëjnë pjesë edhe ecuria e reformës zgjedhore, ecuria e hetimeve ndaj krimeve zgjedhore dhe elementë të tjerë që lidhen me integritetin e zgjedhjeve në Shqipëri.

ISP ka pasur dhe ka përvoja monitorimi të njëjta, nisur me projektin me USAID mbi *“Për zgjedhje të ndershme: Të ndalojmë shpërdorimin e burimeve shtetërore”* (2019-2020), si dhe aktualisht ISP së bashku me ASP (Akademinë e Studimeve Politike), mbështetur nga qeveria e Mbretërisë së Vendeve të Ulta, po jetëson projektin *“Partneritete të forta për reforma të qëndrueshme: forcimi i rolit të shoqërisë civile në adresimin e sfidave për zgjedhje të lira dhe të ndershme”* (2022-2025), një komponent i të cilit është monitorimi i vazhdueshëm i rolit të shtetit dhe burimeve shtetërore në fushata dhe procese elektorale, si dhe ecuria e reformës zgjedhore.

Projekti me KAS shtrihet vetëm gjatë periudhës janar – maj 2023 dhe ka për synim jo vetëm monitorimin, por edhe sensibilizimin mbi standardet zgjedhore, nxitjen e pjesëmarrjes, adresim rekomandimesh për reformën zgjedhore, si dhe monitorim të thelluar në 5 bashki.

Monitorimi i kryer nga ISP është bazuar në një metodologji mikse, në mbledhjen e të dhënave sasiore nga burimet shtetërore dhe publike, si dhe në mbledhjen e të dhënave civile nga monitorimet dhe analizat në terren të ekspertëve. Stafi ka pasur takime me të gjitha palët politike konkurruese në këto bashki, me aktorë të shoqërisë civile, me stafet e monitorimit të KQZ dhe me vetë KQZ, me median lokale, si dhe me ekspertë të zgjedhjeve të përfshirë në monitorimin ose analizimin e procesit.

Zgjedhja e pesë bashkive është bërë për të harmonizuar përvoja të ndryshme dhe kurba të ndryshme politike: pesë bashkitë zënë peshë të madhe specifike në burime njerëzore, materiale, financiare, elektorale, ato paraqesin potenciale të ndryshme konkurrimi, - nga bashki me diferencë të thellë votash midis palëve politike tek ato me diferencë minimale, - si dhe janë pjesë e bashkive të mëdha në krye të hartës së riskut zgjedhor, të hartuar periodikisht nga ISP në secilin proces zgjedhor prej vitit 2015.

ISP falënderon KAS për mbështetjen, KQZ për bashkëpunimin dhe stafin realizues, bashkëpunëtorët, ekspertët, monitoruesit, gazetarët dhe aktivistët që kontribuan.

## **GJETJET KRYESORE TË MONITORIMIT**

---

- I. Procesi zgjedhor 2023 u zhvillua mbi bazën e legjislacionit të miratuar së fundi më 2020, **pa pasur reformë plotësuese zgjedhore** dhe as reflektim të një pjese të madhe të rekomandimeve të ODIHR/OSBE për zgjedhjet e vitit 2019 dhe 2021. Mungesa e reformës zgjedhore krijoi idenë e gabuar se baza ligjore është solide dhe pamundësoi trajtimin ligjor të disa shqetësimeve koherente që lidhen edhe me rolin e shtetit dhe burimeve shtetërore në fushatë elektorale.
- II. Kodi Zgjedhor dhe legjislacioni zgjedhor në Shqipëri **nuk kanë një komentari të detajuar ligjor që shpjegon termat, nocionet, dispozitat dhe ndihmon në njësimin e leximit** dhe interpretimit të tyre. Për pasojë, të njëjtat dispozita, përfshirë ato për rolin e shtetit dhe të burimeve publike, u lexuan në forma të ndryshme nga subjektet konkurruese, media, kandidatët, Komisioneri dhe KAS, dy strukturat vendimmarrëse në KQZ.
- III. Dispozita e Kodi Zgjedhor, neni 91, pika 3, **lidhur me kufizimeve ligjore 4 mujore** për rolin e qeverisë në fushatë për dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, u shoqërua me debat dhe krijoi perceptimin se kemi të bëjmë me dy standarde zgjedhore, një për zgjedhjet parlamentare dhe një për zgjedhjet vendore.
- IV. Partitë politike konkurruese **nuk mbajtën premtimin e dhënë në deklarinim të solemn** të kryetarëve të partive për standardet dhe integritetin e zgjedhjeve dhe të fushatës elektorale. Asnjë parti nuk u bëri thirrje publike mbështetësve të vet për t'u distancuar nga praktikat abuzive të përdorimit të burimeve shtetërore dhe publike në fushatën elektorale.
- V. Partitë politike **nuk kanë mekanizma të monitorimit, reagimit** dhe evidentimit të rasteve abuzive me burimet shtetërore dhe publike. Një thirrje publike e forcës së dytë në opozitë nuk dha efekt, kryesisht për çështje besueshmërie dhe paralelizmi me KQZ, strukturë ku vetë partitë janë të përfaqësuara dhe ku ato kanë rol shumë më të madh vendimmarrës, sesa zhvillimi rutinor i mbledhjeve.
- VI. Bojkoti i zgjedhjeve vendore 2019 nga opozita dhe për pasojë, njësimi i pushtetit qendror me atë vendor me një forcë politike e dobësoi aksesin për transparencë, për ndarje reale të pushteteve, si dhe krijoi lidhje të fortë midis burimeve njerëzore e financiare në dispozicion dhe agjendës elektorale të partisë që qeveris. Opozita drejtoi pjesërisht vetëm një bashki, ndaj ajo nuk kishte akses në burimet shtetërore e publike dhe nuk ishte as objekt monitorimi apo denoncimi. Kjo bëri që denoncimet të adresoheshin tek një parti politike ose aleatë të vegjël të saj, duke i dhënë problematikës konotacion politik.

- VII. Zhvillimi më negativ në drejtim të përdorimit masiv të burimeve shtetërore e publike në fushatë nuk lidhet vetëm me aspektin statistikor dhe të dhënat denoncuese, por me **klimën dekurajuese të krijuar**, se cilido që ka pushtet mund ta përdor atë në funksion të fushatës dhe se përdorimi rezulton i suksesshëm. Fenomeni mbështetet, përhapet, imitohet dhe shndërrohet në normë e sjellje zgjedhore, - fenomene të kundërta me frymën dhe dispozitat e Kodit Zgjedhor dhe parimeve kushtetuese në Shqipëri.
- VIII. Thirrja publike se **bashkitë që votojnë kundër, nuk do të ketë bashkëpunimin e qeverisë** dhe mbështetjen me fonde e projekte të saj, ndihmoi në dobësimin e kulturës politike dhe institucionale. Në tërësi u konstatua mungesë e kulturës politike dhe e njohurive konceptuale lidhur me rolin e burimeve shtetërore në fushatë elektorale. Teza e gabuar se respektimi i të gjitha standardeve të mira zgjedhore në këtë pikë sjell si pasojë paralizimin e punës së bashkive dhe institucioneve në fushatë elektorale, u përsërit nga drejtues të rëndësishëm qendrorë dhe lokal në fazat e aktiviteteve monitoruese.
- IX. Fenomenet e **patronazhizmit, programet online të aktivizmit partiak**, ku ishin të detyruar të regjistroheshin punonjësit e sektorit publik, përbëjnë gjithashtu një zhvillim negativ dhe rast abuzimi të integritetit dhe të standardeve mbi rolin e “shtetërores / publike” në një proces zgjedhor.
- X. **Agjenda e KQZ u dominua** nga praktikat e shqyrtimit, vlerësimit dhe vendimmarrjeve lidhur me denoncimet për përdorimin e burimeve shtetërore, regjistrimin e aktiviteteve, lejimin apo ndalimin e tyre, hetimet për rolin e kryetarëve të bashkive, ministrave apo zyrtarëve të enteve publike në fushatë, si dhe denoncime specifike të tjera lidhur me akte financiare me burimet publike.
- XI. KQZ kreu një numër të madh verifikimesh dhe mori vendimmarrje të shumta, megjithatë **numri i penaliteteve për zyrtarët përgjegjës dhe sidomos për bashkitë e mëdha, ishte minimal (15%)**. Nga monitorimi u krijua përshtypja se KQZ privilegjoi drejtuesit e bashkive të mëdha, përfshirë Tiranën, duke u treguar më i ashpër me bashki të vogla dhe të periferisë.
- XII. Qeveria **krijoi Task – Forcë për zgjedhjet**, por në kundërshtim me detyrimin ligjor, asnjë mbledhje e tij, asnjë dokument dhe asnjë raport nuk është bërë publik. Pretendimet e Task - Forcë se ka funksionuar dhe zhvilluar disa mbledhje me vendimmarrje përkatëse nuk janë provuar ende si të sakta, kërkesave për informim për procesverbalin e mbledhjeve Këshilli i Ministrave i është përgjigjur në mënyrë negative.
- XIII. **Prokuroria dhe organet ligjzbatuese nuk arritën ta trajtojnë në kohë dhe me standarde të njëjta krimin zgjedhor**, si dhe nuk kanë konfirmuar ende asnjë hetim serioz për rastet

e përdorimit të burimeve shtetërore e publike në fushatë apo për abuzimet me postet / fondet shtetërore në funksion të fushatës zgjedhore. Hezitimi për përgjigje ligjore krijoi perceptimin e kjo shkelje e ligjit është e tolerueshme dhe se masa administrative e KQZ është e mjaftueshme.

- XIV. Zgjedhjet vendore 2023 në pesë bashkitë nën monitorim **u dominuan nga fenomeni i përhapur i përdorimit të burimeve shtetërore** për qëllime direkte ose indirekte elektorale. Në bashki si Tirana, Durrësi, Elbasani dhe Fieri e gjithë struktura ekzekutive dhe publike ishte pjesë e fushatës, stafi administrativ ishte pjesë e fushatës, agjenda elektorale u mbivendos mbi atë institucionale.
- XV. Në secilën nga pesë bashkitë në monitorim gjatë gjysmës së dytë të vitit 2022 dhe fillimit të vitit 2023 **pati rritje të punësimeve sezonale**, kryesisht punësime me kontratë të përkohshme dhe nisma praktikash pune, një fenomen kritik që shfaqet gjithnjë në prag të fushatave elektorale.
- XVI. Fushata elektorale **nisi kohë përpara datës zyrtare**, institucionet publike përfshirë pesë bashkitë, përdorën masivisht traditën e muajit fetar për të organizuar, sipas monitorimit, **45 evenimente të mëdha dhe kolektive** me natyrë politike, duke i justifikuar ato në emër të “bamirësisë” dhe “respektit ndaj fesë”. Në festat fetare vijuese pas zgjedhjeve nuk pati asnjë aktivitet të tillë, tregues i lidhjes direkte me natyrën elektorale dhe përdorimin politik.
- XVII. Bashkia Tiranë gëzon privilegjin e kryeqytetit, pranisë në Tiranë të parlamentit, qeverisë dhe selisë së institucioneve kryesore ekzekutive, kushtetuese dhe atyre ndërkombëtare. Një numër i madh i aktiviteteve në Tiranë **nuk kishin ndarje të qartë midis aktiviteteve politike vendore me aktivitetet politike institucionale**. Të gjitha ministritë u vunë në funksion të procesit elektoral, por pa u ndjerë nën presion nga monitorimin nga KQZ, Task - Forca apo shoqëria civile.
- XVIII. Bashkia Durrës **ka numrin më të madh të akteve administrative me natyre financiare gjatë fushatës elektorale**, (36 vendime në një ditë) duke paraqitur edhe rastin më flagrant të përdorimit të aseteve financiare dhe strukturës drejtuese bashkiake (kryetar, këshilli bashkiak, prefektura). Fushata në Durrës u drejtua nga një drejtues i një enti publik, dhe stafet në sektorët e rëndësishëm (arsim, shëndetësi, shërbime sociale, energjetika, bujqësia, etj) u njësuuan me fushatën dhe morën pjesë aktivisht në të.
- XIX. **Bashkia Elbasan dhe Fier** patën gjithashtu nivel të lartë të përdorimit të burimeve shtetërore dhe publike në fushatë elektorale, si dhe numër të madh denoncimesh në KQZ. Kabineti qeveritar dhe agjencitë kryesore, sektorët kryesorë publike ishin pjesë e aktiviteteve dhe mesazheve elektorale.

- XX. **Bashkia Korçë pati nivelin më të ulët të kritikave** dhe denoncimeve përmbajtësore lidhur me burimet shtetërore, tregues i respektimit më të madh të ligjit, por edhe i formalitetit të garës elektorale atje.
- XXI. Në secilën nga bashkitë, **prefekti**, institucion që ushtron kontrollin ligjor të vendimmarrjeve të organeve të qeverisjes vendore në nivel qarku, ishte pjesë aktive e fushatës elektorale, madje në secilin rast, miratues i çdo akti të bashkive dhe pjesë aktive e fushatës së kandidatit për kryetar bashkie, pra nën komandën e autoritetit, të cilin me ligj e kontrollon.
- XXII. **Misioni i ODIHR**, megjithëse pranoi shqetësimin lidhur me përdorimin e burimeve shtetërore e publike, pati vështirësi në identifikimin e shtrirjes së tyre, për shkak të natyrës monitoruese jo hetuese të procesit dhe të mekanizmit. Konsultimi me shoqërinë civile **ishte pozitiv, por i pamjaftueshëm**.
- XXIII. ISP vlerësoi rritjen e interesit publik për të promovuar problematikat që lidhen me përdorimin e burimeve shtetërore në fushatë elektorale. Merita kryesore në rritjen e reagimit publik dhe të KQZ ndaj rasteve të abuzimit me burimet shtetërore **i përket dy aktorëve në këtë tryezë: disa organizatave të shoqërisë civile si QQ, KRIIK, AIS, ASP, KSHH, si dhe disa mediave të pavarura, si BIRN, Fakteje, etj.** Ky është një sinjal domethënës për nevojën e forcimit të zërave civilë dhe medias së pavarur informative në Shqipëri.



## REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIM

---

*ISP shpreh bindjen se cenimi i standardeve zgjedhore përmes keqpërdorimit të burimeve shtetërore e publike nuk është një çështje që zgjidhet me ligje specifike dhe as me “polici zgjedhore”. Zgjidhja shteruese vjen nga ndryshimi i qasjes politike, nga kultura politike dhe sjellja e ndryshuar e aktorëve politikë konkurrues, nga formimi demokratik dhe modeli i munguar i integritetit të liderëve politikë në qeveri dhe në opozitë. Do të mjaftonte një vullnet i qartë politik, qasje vizionare dhe kulturë distancimi ndaj çdo praktike të abuzimit me ligjin e votën, angazhim real për zgjedhje vërtetë të lira, të ndershme dhe të barabarta për të zgjidhur problematikën.*

*Në mungesë të saj, disa rekomandime ligjore janë sugjerime për ecjen drejt zgjidhjes në kushtet ku ndodhet niveli i brishtë i demokracisë funksionale dhe i shtetit të së drejtës në Shqipëri. Ekipi i ISP-së propozon disa rekomandime lidhur me përmirësimet e legjislacionit zgjedhor ose akteve nënligjore të institucioneve të ndryshme të lidhura me zgjedhjet.*

- I. Legjislatura aktuale parlamentare dhe grupet përbërëse mund e duhet të përdorin afatin e ri kalendarik të komisionit të posaçëm për reformën zgjedhore, **për të adresuar dhe trajtuar ligjërisht të gjitha rekomandimet e ODIHR/OSBE** dhe institucioneve civile vendore lidhur me standardet, problematikën dhe shqetësimet rreth përdorimit të burimeve shtetërore në fushatë elektorale.
- II. **Koncepti i kufizimeve të qeverisë në fushatë zgjedhore mund e duhet të njësohet** për secilin proces zgjedhor kombëtar, zgjedhjet parlamentare dhe lokale, duke njësuar rolin vendimmarrës të kufizuar edhe të qeverisë vendore.
- III. **KQZ mund e duhet të hartojë komentarin e plotë dhe integral të Kodit Zgjedhor** dhe legjislacionit plotësues të tij, për të njësuar konceptet, interpretimet dhe vlerësimet mbi dispozitat dhe elementë të detajuar të tyre. Kjo do të ishte në dobi të rritjes së besimit publik të vetë KQZ, evitimit të interpretimeve diametralisht të kundërta midis Komisionerit dhe KAS, përgatitjes më të mirë të të gjitha niveleve të administrimit zgjedhor dhe informimit më të mirë të qytetarëve dhe medias.
- IV. Legjislacioni zgjedhor mund e duhet të trajtojë, duke ia njohur të drejtën KQZ, **për listimin e e një kategori të gjerë funksionarësh publike, të cilët detyrohen të largohen me dorëheqje nga detyra**, si parakusht për lejimin e kandidimit të tyre në fushatë zgjedhore, ose detyrimin e pezullimit të aktivitetit shtetëror gjatë angazhimit të tyre në stafe elektorale dhe fushatë publike të kandidatëve / subjekteve politike. Dispozitat

aktuale në legjislacion janë të paplota, të interpretueshme dhe me hapësira të gjera për keqpërdorim.

- V. KQZ mund e duhet të kryejë plotësime në **vendimin 9/2020** për të përfshirë të gjitha problematikat e konstatuara dhe për të krijuar një bazë ligjore të plotë lidhur me rolin e burimeve shtetërore në fushatë elektorale, identifikimin e tyre, parandalimin dhe disiplinimin e tyre ligjor.
- VI. Ndryshimet në legjislacion mund e duhet të krijojnë **dispozita të qarta lidhur me kufizimet kohore të fushatës elektorale**, për të pamundësuar fushatë përpara periudhës ligjore dhe për të krijuar institucione publike imune ndaj cdo presioni dhe keqpërdorimi paraelektoral, të pa monitorueshëm për shkak se presioni apo keqpërdorimi ndodh në periudhën ligjore jo elektorale.
- VII. Këshilli i Ministrave mund e duhet të miratojë **vendime unifikuese për rolin e zyrtarëve të varësisë në procese zgjedhore**, ndalime të përdorimit të adresës zyrtare dhe identifikimit zyrtar për propagandë apo fushatë elektorale, si dhe krijimin e një modeli Task Forcë shumë më përfaqësues, më të pavarur, më transparent dhe më funksional.
- VIII. Legjislacioni mbi nëpunësit publike dhe civilë mund e duhet **të plotësohet me dispozita shteruese që pamundësojnë punësimet mbi organikë në fushata elektorale**, që limitojnë kontratat e përkohshme dhe i japin fund praktikës abuzive të programeve paraelektorale për punësim në shtet, si dhe formave të tjera abuzive, të konstatuara në raportet kritike mbi zgjedhjet në disa procese zgjedhore.
- IX. Legjislacioni zgjedhor mund e duhet të krijojë **mekanizma të qarta transparentë dhe funksionalë për evitimin e rasteve të vendimmarrjeve të masave financiare mbështetëse** për kategori të caktuara, të motivuara për nevoja politike ditore në prag të fushatës elektorale. Kufizimi 4 mujor nuk vlen vetëm për qeverinë qendrore, por edhe për çdo institucion tjetër publik.
- X. Zyrtarët e lartë partiakë e shtetërore, që shkojnë në fushata, **mund e duhet të financojnë vetë udhëtimet e tyre elektorale, pa u mbështetur në burimet shtetërore** të sigurisë, protokollit, qarkullimit rrugor apo organizimit të aktiviteteve publike mikpritëse. Çdo zyrtar që nuk respekton orarin zyrtar të punës në funksionin kushtetues dhe ligjor në periudhat elektorale duhet të mbajë përgjegjësi, përfshirë ministrat dhe drejtuesit e enteve publike. Aktivitetet elektorale duhet të ndahen qartësisht nga aktivitetet shtetërore, duke përcaktuar masa penalizuese të qarta dhe të prekshme për zyrtarët përgjegjës.

- XI. **Legjislacioni mbi partitë dhe ai zgjedhor duhet të kenë kufizime** për zgjedhjen në organet drejtuese të partive politike të individëve që bëjnë pjesë në institucione publike, i drejtojnë ato ose kanë statusin e nëpunësit civil. Praktikën e drejtimit të fushatave nga zyrtarë të lartë drejtues të enteve publike mund e duhen të trajtohen si shkelje e etikës dhe integritetit të zyrtarëve të lartë.
- XII. Legjislacioni mund e duhet të përcaktojë detyrimin për partitë dhe gjithë strukturën e administrimit zgjedhor dhe administratën publike, **të mos zgjedhin ose emërojnë në poste drejtuese dhe as në administratën publike** individë të penalizuar nominalisht nga KAS & Kolegji Zgjedhor si dhe të dënuar nga sistemi ynë gjyqësor për krimet zgjedhore, përfshirë abuzimin me postin dhe dispozitat lidhur me burimet shtetërore.
- XIII. Institucionet e pavarura, shërbimi diplomatik, organet e sigurisë, institucionet arsimore, etj, duhet të kenë dispozita të qarta masash në rast se zyrtarët përfaqësues gjatë fushatës elektorale bëhen pjesë aktive e saj përmes deklarimeve, mediave sociale apo përdorimit të aksesit online institucional në funksion të reklamave politike.
- XIV. Legjislacioni mund e duhet t'i njohë të drejtën **KQZ të ndërmarrë hapa administrative penalizuese në ndalimin e çdo forme të përdorimit të siglave** dhe simboleve partiake në zyrat dhe mjediset shtetërore, përfshirë edhe faqet online të krijuara nga qeveria qendrore dhe lokale.
- XV. **Legjislacioni duhet të ndalojë qartësisht çdo funksionar politik**, kryeministër, ministër, deputet apo politikan tjetër, **të bëjë deklaratat politike dhe elektorale në takimet zyrtare e publike ku ka prani të institucioneve të pavarura**, siç janë Policia e Shtetit, Forcat e Armatosura, Administrata Publike, gjykatat, prokuroria, shkollat dhe spitalet, kopshtet dhe çerdhet, universitetet dhe akademitë, etj.
- XVI. Legjislacioni zgjedhor duhet të konsiderojë **reklamë dhe aktivitet elektorale** të gjitha aktet e ndihmave humanitare, shpërndarjes së dhuratave, pjesëmarrjes në inaugurime, etj, nga ana e figurave të larta drejtuese politike dhe kandidatëve në zgjedhjet lokale apo parlamentare. Pjesë e trajtimit ligjor duhet të jenë edhe trajtimi si reklamë politike e çdo koncerti apo aktivitet kulturor e sportiv me fonde publike, etj, të organizuar gjatë fushatës elektorale dhe ku ka logo, flamuj, simbole, fjalime, përshëndetje apo apele politike nga figura drejtuese politike dhe kandidatë në fushatë.